



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

Kuvendi Komunal - Junik

Nr. 01-01/23

Datë: 27. 02. 2023, ora 15⁰⁰

PROCESVERBAL

Mbledhjes së Parë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, mbajtur më datën 27 Shkurt, 2023, në orën 15⁰⁰, në lokalet e Kuvendit Komunal në Junik.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin anëtarët e këtij Këshilli si në vijim:

1. Ruzhdi Shehu-kryetar i Komunës - Kryesues i KKS-së,
2. Rasim Sylja- komandant i Stacionit Policor në Junik,
3. Imer Krasniqi – përfaqësues i Bashkësisë Islame,
4. Zejnepe Gaxherri – kryesuese e Komitetit për Komunitete,
5. Xhevahire Krasniqi – zyrtare për Barazi Gjinore,
6. Xhavit Gaxherri -kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës së Junikut,
7. Shkëlzen Shehu – përfaqësues i Emergjencave Civile Komunale,
8. Qamil Jasiqi– përfaqësues nga Komuniteti i Personave me Aftësi të Kufizuara.
9. Driton Sylja-“Teqja e Madhe Amë e Tarikatit Alijjei- Haletije Xhaferi”, Junik, dhe
10. Arbër Gjota – përfaqësues i Këshillit Lokal për Siguri Publike.

Në këtë mbledhje munguan; Albestrim Rexhepi - përfaqësues i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Xhavit Velijaj – drejtor i Drejtorisë për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, Afërdita Shehu - kryesuese e Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi, Leonita Jasiqi - përfaqësuese e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Arsim Shehu – përfaqësues nga Komuniteti i Biznesit, dhe Dukagjin Lllolluni – përfaqësues nga OJQ.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe drejtori për Shëndetësi z. Fatos Shala dhe zyrtari i lartë i Arsimit në Komunën e Junikut z. Artan Krasniqi.

Mbledhjen e Parë të Rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2023 e shpalli të hapur kryesuesi i KKSBB-së z. Ruzhdi Shehu, i cili përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhjeje, dhe nga anëtarët e Këshillit kërkoi miratimin e Rendit të Ditës si më poshtë:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut,
3. Kodi i Etikës, personeli mjekësor, dhe gjendja me barna dhe materiale esenciale në QKMF në Junik,
4. Raport mbi përmasat zhvilluese të pandemisë Covid-19 për periudhën 2022-2023,
5. Mësimi në kohë pandemie dhe shëndeti tek nxënësit e Komunës së Junikut,
6. Diskutim mbi gjendjen e të moshuarve dhe hapat që duhet të ndërmirren nga Komuna e Junikut, dhe
7. Të ndryshme.

Ky Rend i Ditës u miratua nga anëtarët e pranishëm në këtë mbledhje të KKSBB-së.

Pika e parë të Rendit të Ditës,
Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi z. Ruzhdi Shehu kërkoi shqyrtimin e procesverbalit të kaluar, i cili me 10 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua nga anëtarët të KKSBB-së.

Pika e dytë e Rendit të Ditës,
Gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut

Fjalën e mori Komandanti i Policisë në Junik z. Rasim Sylja, i cila tha, gjendja e sigurisë në Komunën e Junikut në përgjithësi është e qetë. Ne po punojmë 24/7 në mbulim të terrenit, si me prezencën tonë ashtu edhe përmes informatave. Jemi duke mbajtur pika të kontrollit të shpeshta. Jemi furnizuar me radarë me qëllim të parandalimit të aksidenteve, dhe nuk ka tolerancë ndaj atyre të cilët e kalojnë shpejtësinë e lejuar në komunikacion.

Kemi disa projekte dhe plane operative në zbatim, me qëllim të parandalimit të të gjitha dukurive negative.

Ne sipas sezonave planifikojmë dhe zhvillojmë veprimet në terren për qëllim të sigurisë dhe rehatisë më të mirë për qytetarët.

Tani veç po fillon stina e Pranverës, ndërsa njerëzit bëjnë pastrimin e fushave, livadheve dhe pronave të tyre, ku bëjnë edhe djegien e këtyre mbeturinave, të cilat zjarre po shkaktojnë telashe, po e ndotin ambientin dhe po dëmtojnë pronat, dhe shpesh po dalin jashtë kontrollit. Kohëve të fundit kemi pasur dy raste të tilla të cilat nuk bien ndesh me sigurinë, por me ndotjen e ambientit dhe telashe të tjera.

Unë kërkoi, që sipas mundësive të bëhet një fushatë që përmes Komunës të bëhet disa posterë në hyrje dhe dalje të Junikut, apo përmes web-faqes së Komunës kundër zjarrvënies. Nëse këto nuk janë shumë të kushtueshme do të na ndihmonte shumë.

Ne i japim prioritet sigurisë në shkolla dhe kemi një pikë statike çdo mëngjes, dhe jemi në përfundim të zbatimit të një pilot-projekti së bashku me prindërit, në mënyrë që të jetë një siguri pak më të madhe për nxënësit në shkolla.

Këtë muaj nuk kemi pasur vepra penale. Kemi shqiptuar rreth 60 gjoba në trafik dhe shumica e tyre janë për tejkalim të shpejtësisë, dhe po punojmë që të kemi sa më shumë integritet policorë karshi qytetarëve të Junikut.

Z. Shkëlzen Shehu kërkoj që këta posterë të vendosen në çdo lagje, dhe të publikohen edhe në web-faqen e Komunës.

Z. Ruzhdi Shehu tha, është mirë që të printohen edhe broshura të cilat do të shpërndahen përmes postes në secilën shtëpi në Junik.

Z. Xhavit Gaxherri tha, siç u cek edhe më herët këto zjarre mund të dalin jashtë kontrollit, dhe përveç se e ndotin ambientin, rrezikojnë edhe qytetarët dhe pronat e tyre. Kështu që do të ishte mirë që përveç broshurave të cilat shpërndahen derë me derë është mirë që të bëhen posterë dhe të vendosen në vende publike të cilat do të rrisin vetëdijesimin, jo vetëm në Junik por edhe në fshatrat përreth. Pra, kjo është një ide e mirë, dhe shpresoj të materializohet dhe të kthehet në fushatë aktive.

Unë isha ndërlidh edhe te çështja e rregullimit të komunikacionit në drejtim të Shkollës Fillore, që është një shqetësim i prindërve qysh herët, për shkak të ngushtësisë së rrugës dhe qarkullimit mjaft të theksuar, sidomos në mëngjes, që mund të vjen deri të ndonjë pasojë për nxënësit tanë.

Është mirë që ky rregullim i komunikacionit të jetë i pranishëm dhe funksional. Pra, këto janë nisma me rëndësi për sigurinë publike në komunën tonë.

Z. Imer Krasniqi pyeti nëse çështja e djegies së mbeturinave ka të bëjë me çështjen e deponisë, ndërsa theksoj se këto djegie ilegale të mbeturinave mund të jenë edhe me fatalitet?!

Z. Ruzhdi Shehu tha, edhe kjo hynë të fusha e sigurisë, dhe ne duhet t'i informojmë edhe qytetarët se asnjë mbeturinë nuk mund të hidhet në ambient, kjo nuk është e lejueshme. Çështja e deponisë së mbeturinave inerte përkohësisht është caktuar te "Joos Krasniqi", ku këto mbeturina mund të hidhen aty pa pengesë, pra kjo duhet të publikohet në web-faqe. Sa u përket druve, mobileve, e të tjera, është e ndaluar hudhja e tyre dhe se ato duhet të trajtohen nga vet qytetarët për nevojat e tyre.

Policia ka të drejtë që këto raste t'i penalizoj dhe t'i dënoj, sepse kjo ka të bëjë me mbrojtjen e ambientit.

Tjetër, unë kisha kërkuar nga zjarrfikësit dhe policia të marrin masa të rrepta ndaj atyre që hedhin mbeturinat skaj rrugës, sepse kjo do të bënte vetëdijesimin e tyre.

Është diskutuar në Këshillin e Sigurisë që të vendosen disa pengesa në rrugë, mirëpo Ministria nuk lejon që këto të vendosen në rrugët regjionale. Pra, kjo është gjendja për tani. Ne do të përgatitemi t'i publikojmë në web-faqen e Komunës edhe masat që janë për mbrojtjen e ambientit për mbeturina, ndërsa për ato inerte veç i kemi publikuar tashmë.

Ne jemi duke menduar që deponia e materialeve inerte të bëhet në një lokacion tjetër. Pra, ne kemi angazhuar një kompani në mbështetje të gjermanëve që të bëhet analiza e qëndrueshmërisë së ndërmarrjes për menaxhimin e mbeturinave, si dhe atyre të amvisërisë, por akoma nuk kemi raport prej tyre.

Tjetër, është bërë rritja e çmimit të grumbullimit të mbeturinave në rajon, mirëpo te ne është akoma e njëjtë, dhe jemi duke tentuar që t'i kyçim të gjithë qytetarët për të paguar për këtë shërbim, sepse duhet të ketë një kontratë, pra 90% të qytetarëve tashme bëjnë pagesën dhe kanë një kontratë të tillë.

Z. Xhavit Gaxherri, pyeti se si të bëhet zgjidhja e eshtrave të kafshëve të therura në Junik?

Z. Ruzhdi Shehu tha, ky është një problem në nivel Qendror. Ne keni kontaktuar me një kompani në Prishtinë për riciklimin e këtyre eshtrave, mirëpo akoma nuk kemi ndonjë zgjidhje, angazhohemi që të bëjmë thirrje për sensibilizim edhe përmes web-faqes për trajtimin e të gjitha llojeve të mbeturinave, sepse kjo është sfidë në vete.

Z. Rasim Syla kërkoj nga kryetari z. Ruzhdi Shehu që policisë t'i bashkëngjiten edhe inspektorët e Komunës, dhe të bëhen kontrole të përbashkët në një afat të caktuar prej dy javësh, në mënyrë që njerëzit të bëjnë disa inçizime dhe të shohim ndryshimin, dhe të kuptojnë se si qëndron çështja, në mënyrë që të përmirësohet gjendja e mbeturinave dhe siguria në komunikacion.

Z. Imer Krasniqi kërkoj që të bëhet një mobilizim nga qytetarët për pastrimin e Junikut nga mbeturinat.

Z. Driton Syla ngriti çështje e shpejtësisë së automjeteve pranë Teqës së Madhe në Junik, dhe kërkoj që të merren masa lidhur me këtë.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu kërkoj nga policia që të merren masa për ata që tejkalojnë shpejtësinë e lejuar me shenjat e komunikacionit.

Pika e tretë e Rendit të Ditës,
Kodi i Etikës, personeli mjekësor, dhe gjendja me barna dhe materiale esenciale në QKMF në Junik

Këtu, fjalën e mori z. Fatos Shala i cili tha, të gjithë të punësuarit në QKMF sjelljen e tyre e bazojnë në Rregulloren Nr. 4/2015, që është kodi për sjellje të Shërbyesve Civil në Republikën e Kosovës. Gjithashtu duhet t'iu përmbahen parimeve themelore të ligjit nr. 3/L-149 për Shërbyes Civil. Kjo është ajo sa i përket ligjshmërisë, përndryshe nuk kemi ndonjë ankesë që ka të bëjë me thyerjen e Rregullores dhe mirësjelljen e stafit të QKMF-së. Personeli mjekësorë tani është i plotësuar dhe gjithsej janë 33 të punësuar e që respektojnë Kodin e Etikës apo Mirësjelljes.

Gjendja me barna esenciale për gjashtëmujorin e parë ka qenë e pranueshme apo e mirë, kurse për gjashtëmujorin e dytë sipas raporteve nuk ka qenë e kënaqshme.

Furnizimi me tableta ka qenë rreth 80%, me ampula rreth 50%, me infuzione rreth 20%, me insulinë 90%, dhe me materiale shpenzuese rreth 90%.

Në takimin e fundit që kemi pasur me Ministrin para disa ditëve, ai është zotuar se nuk do të ndodh që të mbesim pa furnizime, dhe arsyetimi ka qenë vakumi i Ministrit të Shëndetësisë dhe disa kontratave, por kemi premtime se tani e tutje nuk do të ketë probleme të tilla.

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, furnizimi me barna esenciale është obligim i Ministrisë së Shëndetësisë. Ne nuk jemi të kënaqur me këtë furnizim. Kjo është për shkak të një menaxhimi jo të mirë nga ana e tyre, dhe ngjashëm është edhe në komunat tjera.

Ky furnizim është kompetencë e Ministrisë së Shëndetësisë, dhe ne nuk guxojmë të bëjmë shkelje në lidhje me këtë çështje.

QKMF-ja në Junik kryen shërbime deri në orën 21:00. Jemi në proces të mundësisë së funksionimit 24 orë të QKMF-së. Kemi shpallur konkurs për një radiolog, por akoma nuk e kemi ndokënd të interesuar për këtë pozitë deri më tani. Ne po kryejmë shërbime shëndetësore edhe për fshatrat përreth, pra për qytetarët jashtë Komunës së Junikut, por për shërbim 24 orë të QKMF-së na duhen edhe tre-katër punëtorë të tjerë shëndetësorë.

Z. Xhavit Gaxherri pyeti se si funksionon barnatorja brenda QKMF-së dhe sa kanë qasje qytetarët në këtë barnatore?

Z. Fatos Shala tha, kjo barnatore bën furnizimin esencial siç janë; tabletat për diabet, yndyrë dhe të ngjashme, dhe për këto ka furnizim të mjaftueshëm.

Ne kemi bërë edhe furnizime me infuzione me të hyrat apo fondin e Komunës, në mënyrë që t'u dalim ndihmë qytetarëve, mirëpo nuk kemi mundur t'i plotësojmë të gjitha kërkesat e tyre, sepse rreth 45% të pacientëve janë nga komunat jashtë Junikut, kryesisht të fshatrave të Rekës së Keqe të Komunës së Gjakovës.

Pacientët e QKMF-së në Junik njoftohen nga mjekët për barnat në dispozicion në këtë barnatore, të cilat përshkruhen nga mjeku.

Pika e katërt e Rendit të Ditës

Raport mbi përmasat zhvilluese të pandemisë Covid-19 për periudhën 2022-2023

Edhe për këtë pikë z. Fatos Shala tha, për vitin 2022 kemi paraqitur raporte për KKSBB dhe për Kuvendin Komunal për numrin e rasteve, ku kanë qenë 271. Nga një raport i mëparshëm në vitin 2022 janë bërë 640 testime, kurse për vitin 2023 deri më tani gjendja ka qenë stabile. Nuk kemi patur raste të konfirmuara pozitiv. Ka rekomandime që të shtohen masat disiplinore, ndërsa QKMF-ja ka marrë si urdhëresë që të përdoren maskat nga stafi aty, pra janë marrë masa mbrojtëse, dhe shpresojmë që situata nuk do të keqësohet, dhe t'i dalim edhe këtë periudhë.

Pika e pestë e Rendit të Ditës

Mësimi në kohë pandemie dhe shëndeti tek nxënësit e Komunës së Junikut

Për këtë pikë fjalën e mori z. Artan Krasniqi i tha, unë nuk isha ndal te kjo pikë sa i përket vitit 2023, sepse na veç kemi raportuar për gjithë ecurinë se çka ka ndodhur në shkollat në

kohë pandemie, por unë kisha raportuar për tremujorin e fundit. Nga 27 Dhjetori, 2022 deri me 06 Shkurt, 2023 shkollat kanë qenë në pushim të gjysmëvjetorit të parë, ndërsa nga 06 Shkurti deri më tani nuk kemi ndonjë rast të raportuar as nga personeli arsimorë as nga nxënësit, përveç gripit sezonal që ka zgjatë nga 5 deri në 7 ditë, i shoqëruar me temperaturë, mirëpo nuk është përcaktuar që ka pasur virus apo Covid-19.

Informatat që kemi marrë nga drejtorët e shkollave për ata nxënës që kanë qenë me temperaturë apo grip kanë qëndruar në shtëpi, ndërsa të tjerët kanë vazhduar mësimin e rregullt.

Kemi marrë të gjitha masat për furnizimin e shkollave me material higjienik që kërkohet, dhe kemi kontakte ditore me drejtorët e shkollave. Pranojmë edhe raporte, dhe deri më tani gjendja në shkolla është stabile.

Z. Imer Krasniqi pyeti se si është gjendja me nxemje në shkolla?

Z. Artan Krasniqi tha, sa i përket sistemit të ngrohjes unë mund të them se jemi munduar t'i shfrytëzojmë kapacitetet për ngrohje. Kemi pasur mungesë të druve, por jemi në proces të ri-tenderimit për furnizim me dru të tjera, por si përparësi këtë vit ka qenë moti i butë gjatë këtij dimri.

Pika e gjashtë e Rendit të Ditës

Diskutim mbi gjendjen e të moshuarve dhe hapat që duhet të ndërmerren nga Komuna e Junikut

Kryetari z. Ruzhdi Shehu tha, unë dëshiroj t'iu informoj se çështja e të moshuarave vërtetë do të jetë problematike, pra trajtimi dhe kujdesi ndaj tyre për shkak të ikjes dhe migrimit të të rinjve, dhe kjo kërkon një studim se si të trajtohet kjo çështje.

Z. Imer Krasniqi kërkoj nga niveli komunal që personat e vetmuar të shërbehen të paktën me nga një shujtë ditore ushqim.

Z. Ruzhdi Shehu tha, Juniku në këtë aspekt nuk është në gjendje të keqe. Ne jemi munduar që t'i shpërndajmë 600-700 Euro, mirëpo nuk kemi gjetur ndonjë familje në Junik që t'i pranoje ato, dhe kjo është për t'u gëzuar.

Z. Xhavit Gaxherri tha, duke pasur një situatë të tillë të të moshuarve të vetmuar në Junik, të shqyrtohet mundësia që atyre t'u ofrohet një lokalitet nga Komuna, i cili do t'u dedikohet të gjithë pensionistëve për socializmin e tyre.

Z. Ruzhdi Shehu tha, kemi problem vazhdimin e kartonit që kërkohet për vazhdimin e pensioneve, të cilin e kemi ngritë në nivel të Ministrisë dhe kemi pasur një konkurs të brendshëm që të punohet dy ditë në Junik dhe tri ditë në Deçan, por nuk kemi gjetë gatishmëri për një pozitë të tillë. Por unë besoj se kjo do të zgjidhet, por së fundi ne mund ta kryejmë këtë shërbim duke shkuar të shtëpitë e pensionistëve, në mënyrë që t'i vërtetojmë dhe vazhdojmë afatin e kartonëve e tyre.

Pika e shtatë e Rendit të Ditës
Të ndryshme

Z. Imer Krasniqi ngriti çështje e morgut në Komunën e Junikut dhe tha, se si ide në kuadër të QKMF-së të organizohet si morg, meqenëse e kemi larg Pejën dhe Gjakovën. Pra, të arsyetohet në këtë formë, dhe që është brenda institucionit, pastaj ne aty i kishim kryer shërbimet tona.

Z. Ruzhdi Shehu tha, unë kam pyetur në zyrën ligjore, por nuk lejohet që institucioni të ketë qasje të përditshme për shërbimet që marrin njerëzit. Pra, kjo është e kufizuar në vend të caktuar, por mbetet të shikohet mundësia për gjetjen e një lokacioni të përshtatshëm për këtë shërbim.


Z. Imer Krasniqi ngiti edhe çështjen e ditës së pushimit për bizneset në Junik, dhe kërkoj që dita e Diel të jetë ditë pushimi, sikurse ka qenë në fuqi gjatë periudhës së Covid-it.

Z. Ruzhdi Shehu tha, Komunitat nganjëherë i kalojnë kompetencat e veta. Unë kam punuar në Ministri ku rregullohet normativa e tregtisë dhe shërbimeve. Barnatoreve nuk mund t'u ndalohet puna sepse ato bëjnë edhe kujdestari.

Tjetër, këtë nuk mund t'ua imponosh të gjithëve. Kjo mund të bëhet përmes inspektoriatit të Punës, i cili është përgjegjës që ta këqyrë secilin biznes nëse ka kontratë pune për ditën e Shtunë dhe të Diel, mirëpo ne do të mundohemi që të bëjmë një zgjidhje edhe për këtë çështje.

Me kaq, kryesuesi, z. Ruzhi Shehu shpalli të mbyllur këtë mbledhje të KKS-së.

Procesmbajtësi,


Gëzim Geci

Kryetari i Komunës, Kryesues i KKS-së


Ruzhdi Shehu